

## **AKT THEMELIMI I SHOQERISE "AS LINE "SH.P.K,**

Ne të nënshkruarit ; **Enkeleda FETI me Nr. ID I76108013J**, datëlindje 08.11.1987 dhe banuese në Tiranë, si dhe **Rikeldo BALLO me Nr. ID K00706003Q**, datëlindje 06.07.2000 dhe banues në Tiranë, sot më datë 02.03.2021 shprehim dëshirën për krijimin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar sipas kërkesave të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare" dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" QKR , me të dhenat e mëposhteme :

### **NENI 1**

Themeluesit me anën e këtij Akti Themelimi krijojnë një Shoqeri me Përgjegjesi të Kufizuar SHPK , të cilën do ta emertojmë **AS LINE Shpk**, shoqeri e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i bashkalidhet këtij Akti Themelimi.

### **NENI 2**

Selia e Shoqerise do të jetë në Tiranë, në adresën Tiranë, Njesia Administrative 14 Yzberisht, Rruga "Sokrat Miho", Zona Kadastrale nr.3866, nr.i pasurisë251/68 +4 -N3. Shoqeria do të ushtrojë veprimtarinë për një periudhë **kohe të pakufizuar, mbi 10 vjet**, me të drejtë perseritje për periudhën e mëtejshme, në qoftese ortakët bien dakort, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **NENI 3**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë : Shërbime të ndryshme në fushën e ndertimit, tregti me pakice e artikujve të ndryshëm të ndërtimit,elektrike, kondicionim, ngrohje-ftohje, ajrim, ventilim, hidraulike , higjieno sanitare , kozmetike e të tjera. Import e tregtim i mallrave, paisje, aparatura dhe material mjekësore dhe laboratorike, sisteme dhe impiante spitalore , paisje, aparatura makineri, materiale dhe artikuj të ndryshme si filtra uji, impiante uji, lëndë për trajtimin e ujit (kemikale), paisje laboratorike, kite, reagent e të tjerë. Projektim dhe realizim i impianteve të gazrave mjekësore spitalore, salla operimi, sistemeve elektrike dhe hidraulike e të tjerë. Konsulencë, vlerësim, instalim, trajnim, servis, riparim, mirëmbajtje dhe kolaudim të aparaturave e makinerive mjekësore, impianteve dhe sistemeve të ndryshme. Shërbime të impiantit të ujit për analiza laboratorike, Shërbime teknike të impiantit të ujrave të dekantuar. Analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit , të impianteve të komandimit elektrik-elektronik të ujrave të dekantuar dhe të ujrave laboratorike.

**Per të gjithë aktivitetet për ushtrimin e të cilave kërkohet license e posacme , shoqeria do të ushtrojë aktivitetin pasi me parë të jetë pajisur me licensen perkatëse nga organet kopetente.**

### **NENI 4**

Kapitali themeltar i shoqerise është 100.000 Lekë ( njëqind mijë ) . Ky kapital është i përbërë nga 2 kuota, çmimi i se ciles është 50,000 Lekë ( pesëdhjetëmijë) Leke . Sejcili Ortak zotëron nga 1 kuotë ose nga 50% të gjithë kapitalit të shoqerise.

### **NENI 5**

Kapitali i shoqerise mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marrë Asamblea e Përgjithshme e Ortakve. Në rast se kapitali i shoqerise për shkak të humbjeve të vertetuara në dokumentat financiare rezulton me i vogël se gjysma e Kapitalit Themeltar, Asamblea e Përgjithshme e Ortakve vendos, brenda tre muajve nga miratimi i llogarive dhe rezultatit

financiar të ushtrimite, mbi mundesine e prishjes se parakoheshme te shoqerise. Ne rast se prishja nuk shpallet, shoqeria zvogelon kapitalin e saj me nje vlere jo me te vogel se ajo e humbjeve qe kane mbetur, pa mbuluar nga fondet rezerve.

#### **NENI 6**

Sejcili prej Ortakve mund të vendosë për shitjen kuotave te kapitalit te tij, teresisht apo pjeserisht, Ortakve të tjerë te shoqerise, te cilet kane te drejten e parablerjes qofte edhe ne kushte te barabarta. Kjo e drejte duhet ushtruar brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

#### **NENI 7**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- Asamblea e Përgjithshme e Ortakve
- Administratori

**Afati i emerimit te administratorit eshte 5 vjet, me te drejte riperseritje , ne baze te nenit 95 te Ligjit 9901, dt.14.04.2009, sic eshte percaktuar ne statut.**

Procedura per emerimin ne funksionet perkatese dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas statutit te shoqerise.

#### **NENI 8**

Administratori i shoqerise emërohet **Znj. Enkeleda FETI**, lindur me 08/11/1987, ne Korçë dhe banuese ne Tirane, me dokument identifikimi Kartë Identiteti ID dhe nr personal 176108013J, shtetas Shqiptar. Aafati i emërimit të administratorit të shoqerisë do te jete 5 vjet.

#### **NENI 9**

Vendimet e Asamblesl së Përgjithshme mund te merren edhe nepermjet konsultimit me shkrim.

#### **NENI 10.**

Likujditet dhe transaksionet financiare do te depozitohen ne bankat shqiptare dhe ne ato te huaja, ku shoqeria ka llogaritet e saj rrjedhese. Per kapitalin themeltar te shoqerise eshte hapur libri i llogarive ku do te shenohet kontributi i sejcilit ortak. Po keshtu shoqeria ka dhe perdor dokumentacionin sipas kerkesave te ligjit per kontabilitetin dhe të gjithë kerkesave te tjera financiare te domosdoshme per veprimtarine normale te saj.

#### **NENI 11**

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria i shpërndahet ortakve ne perpjestim me kontributin e sejcilit ne Kapitalin Themeltar te shoqerise, mbasi te jene likujduar te gjitha detyrimet, dhe te jene hequr 5 % qe do te futet ne fondin e Rezerves së Domosdoshme deri ne permbushjen e 1/10 te Kapitalit te shoqerise.

#### **NENI 12**

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi.

#### **NENI 13**

Ortakët janë të detyruar te ruajne karakterin sekret te dokumentacionit, te eksperiences se shkembyer, te realizuar brenda veprimtarise se shoqerise .

#### **NENI 14**

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptin, do te paraqiten per zgjidhje ne gjykaten kompetente shqiptare, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

#### **NENI 15**

Ky akt themelimi u perpilua ne prani te ortakve duke shprehur ne te vullnetin e lire te tyre.

Akti i themelimit u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila, per t' u depozituar ne organet kompetente, tatimore, ne zyren e noterise, si dhe nje kopje te ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ne Datë 02/03/2021

### ORTAKËT

**Enkeleda FETI**



**Rikeldo BALLO**

